



**Republika e Kosovës**



**Komuna e Kaçanikut**

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2020

**Procesverbal**

**Takimi i IV-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020**

**Më 21.09.2020**

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës

**Halim Shehu**, Komandant i Policisë-Kaçanik

**Armend Bikliqi**, përfaqësues i FSK-së

**Kjani Sallahu**, FOJK

**Fatmir Qaka**, EVSB

**Shemsedin Abazi**-KLSP

**Ramadush Osmani**-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

**Lirije Luta**- Komiteti për Komunitete

**Zahir Doda**-Drejtor i DAK

**Jashar Selimi**-Këshilli i Prindërve

**Fidaim Fazliu**-Bashkësia Islame

**Fadil Guri** -ZKKK

**Vedat Dema**-Zyra për Barazi Gjinore

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut z. **Besim Ilazi** i cili prezentoit pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
3. Trajtimi i mbeturinave dhe menagjimi i mbeturinave gjat stinës së verws
4. Formimi i grupit punues pwr hartimin e Planit Vjetor tw Punws pwr vitin 2021
5. Të ndryshme

### **1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar**

-Proces verbali u miratua nga të gjithë të pranishmit

### **2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut**

-Reth pikës së dytë të rendit të ditës **Komandanti i Policisë** tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile. Shqetësuese është dukuria e vjedhjeve e cila ka pasur një shtrirje bukur të madhe në komunën tonë. Kemi arritur të kapim një grup personash të organizuar të cilët janë nga komuna e Podujevës dhe i cili grup kët veprimtari e ka zhvilluar edhe në regjione tjera. Në kët periudhë kohore kemi pasur vjedhje, tentim vjedhje, vjedhje e rëndë dhe tentim vjedhje e rëndë gjithësejtë 20 raste, lëndim i lehtë trupor dy raste, lëndim i rëndë trupor një rast dhe këto lëndime kanë ardhë si pasojë e një rrahje që ka ndodhur në një kafiteri. Dukuri tjera devijante ka pasur kanosje një rast, dhunë në familje një rast, dëmtim prone gjashtë raste, incident zjarri një rast, pengim i personit zyrtarë në kryerje të detyrës një rast, armëmbajtje pa leje një rast dhe falsifikim i parasë dy raste. Gjithashtu kemi pasur edhe raste të ndalimit dhe ndëshkimit të personave që nuk kan mbajtur maska. Gjithësejtë janë inicuar dhe janë duke u trajtuar 48 raste gjat kësaj periudhe kohore. Duhet përmendur edhe një qështje në lidhje me dëmtimin e pyjeve, ku axhensioni për ruajtjen e pyjeve ka lëshuar taksa për pastrimin e pyjeve dhe në emër të kësaj takse me të madhe pyjet janë duke u dëmtuar.

**K. Sallahu:** Nëse i refrohemi raportit të prezantuar nga Komandanti i Policisë, situata e sigurisë në përgjithsi është shqetësuese. Ndërkëq, sa i përket dëmtimit të

pyjeve, mendoj se kjo temë më nuk duhet të shtrohet në KKSBS, prandaj duke qenë edhe njëri nga hartuesit e planit të KKSBS-së, nuk e kemi paraparë asnjëherë në agjendën vjetore. Aq shumë kemi folur për pyjet dhe kemi bërë rekomandime sa s'ka më, por asgjë nuk ka ndryshuar në terren. Prerja e pyjeve ndalohet nga ata të cilët janë kompetentë për t'i ruajtur pyjet dhe nga ata të cilët janë kompetent për ta zbatuar ligjin. Ne kemi rekomanduar të gjitha institucionet relevante për të vepruar në këtë drejtim dhe ata nuk po veprojnë, prandaj e kemi këtë gjendje. KKSBS këshillon, por nuk ka kompetenca ekzekutive për masa, prandaj këtu përfundon mundësia e jonë.

**Kryetari :** Pjesa e parkut nacional menagjohet nga agjensioni i pyjeve dhe unë nuk shoh një gadishmëri nga ata për ta mbrojtur kët hapësirë të pyjeve. Për shkak të neglizhencës së tyre ne e kemi të pamundur për të ndryshuar gjendjen.

**Z.Doda:** Nga java e kaluar një pjesë e nxënësve kan filluar mësimin nëpër shkolla e nga sot procesi mësimor ka filluar me të gjitha nivelet. Ministria e Arsimit na ka kompletuar me udhëzime të cilat udhëzime jemi munduar tua përcjellim të gjitha shkollave. Në nivel komunal kemi formuar TASK-FORC-ën e cila udhëhiqet nga Kryetari i Komunës dhe do të mbajmë takime të rregullta për të menagjuar situatën. Kërkesa ime është që të mobilizohemi të gjithë maksimalisht që të ruajmë shëndetin në përgjithsi.

**Kryetari:** e inicuar nga shoqëria civile ne kemi formuar TASK-FORC-ën për mbrojtjen e pyjeve por që shoh se nuk është bërë asgjë në kët drejtim edhe pse e kan pasur përkrahjen time .

**K.Sallahu:** Shoqëria Civile mund të shprehë shqetësimin dhe të monitorojë sektorin e pyjeve, por nuk kanë kompetenca për ta ndaluar prerjen e pyjeve. Përfshirja e një individi apo një OJQ-je në një Task Forcë për mbrojtjen e pyjeve, nuk do të thotë përfshirje e gjithë shoqërisë civile dhe nuk do të thotë dhënie e kompetencave ekzekutive për ndalimin e kësaj dukurie. Shteti e ndalë, shteti s'e ndalë.

**Kryetari :** nuk mendoj se Shoqëria Civile e ka vetëm rolin monitorues por që duhen të jenë alarmues dhe të ngrisin shqetësime dhe nga ana e institucionit do ta kenë përkrahjen.

**K.Sallahu :** Shoqëria civile e ka alarmuar këtë problem, i ka ftuar në takim zyrtarët e mbrojtjes së pyjeve, Komunën, policinë, prokurorinë, gjykatata dhe ka kërkuar nga ata që ta luajnë rolin e tyre dhe t'i ushtrojnë kompetencat ekzekutive, ndërsa rezultatet janë këto që po i shohim.

**K. i Policisë** : ne mundë të bashkëpunojmë në parandalimin e prerjes ilegale të pyjeve por që nganjëherë ndodhë që vet qytetarët po na pengojnë në kryerjen e punës tonë duke e arsyetuar veprën e disa individëve që dëmtojnë pyjet .

**F.Fazliu** : Më intereson të dijë se si është gjendja e sigurisë nëpër shkolla në kët situatë dhe një shqetësim tjetër kisha me e ngritë në lidhje me një person që shfaqë sjellje jo të mira sidomos nëpër xhami e i cili para disa kohe në shtëpinë e kulturës ka penguar një aktivitet të Bashkësisë Islame . Më e keqja është se ky person është mësimdhënës dhe veprimet e tij prishin imazhin e institucionit arsimor .

**K. i Policisë**: Lidhur me veprimet e këtij personi ne jemi ballafaquar disa herë dhe ne e kemi marrë në intervistim dhe lëndën e kemi përcjellë në prokurori . Ky person këto veprime i bënë sidomos nëpër xhami dhe atë kur është në gjendje të dehur . Ne jemi interesuar për kët person se mos është i sëmurë mental , por që nuk posedon asnjë dokumentacion nga institucionet shëndetsore .

**Z.Doda** : jam në dijeni në lidhje me sjelljet e këtij mësimdhënësit por që në bazë të informacioneve që kam , ai gjatë orarit mësimorë është shumë i arsyeshëm dhe kryen punën si duhet . Këto veprime ai i bënë jashtë objektit shkollorë , dhe në gjendje të dehur Nuk di se a kam të drejtë të marrë masa kur këto veprime ai i bënë jashtë orarit të punës .

**K. Sallahu**: Sjellja e tillë në publik e një mësimdhënësi është vërtet imazh shumë i keq për nxënësit dhe shkollat. Dhe ky problem nuk do arsyetim, por do zgjidhje institucionale. Më vjen shumë keq për personin në fjalë të cilin e njoh që nga shkolla fillore si njeri jashtëzakonisht i mirë dhe shembull i mirë për të gjithë, por edhe si familje jashtzakonisht e mirë. Jam shumë i sigurt se me vetëdije të plotë ai person kurr nuk i bën ato veprime. Nëse këto ndodhin nga ndikime të tjera, njerëzisht nuk kemi të drejtë t'ia zëmë për të madhe, por institucioni duhet të veprojë, sepse bëhet fjalë për nxënës e shkollë.

**Z.Doda**: edhe në një shkollë tjetër e kemi një rast me një ish mësimdhënës që insiston se ka të gjitha të drejtat të bazuara në dokumentacionet që posedon të lëshuara nga institucionet juridike që të ushtroj profesionin e mësimdhënësit e që neve na ka krijuar probleme .

**F.Guri**: duhet ti dallojmë procesin administrativ nga ai penal. Nga Drejtori u tha që në procesin mësimorë personi në fjalë është shum i arsyeshëm , ndërsa për veprimet e tij devijante jashtë orarit mësimorë vlejnë penalizimet .

**F.Fazliu**: mendoj se ky person shfaqë veprime devijante edhe mbrenda objektit mësimorë por që rastet duhet të denoncohen .

### **3. Trajtimi i mbeturinave dhe menagjimi i mbeturinave gjat stinës së verës**

-Në këtë pikë të rendit të ditës , Drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencë tha se menagjimi i mbeturinave bëhet nga kompania e kontraktuar, ndërsa për mjedis komuna angazhon kapacitete tjera njerzore përmes kontratës në vepër për pastrim të rrugëve dhe parqeve në qytet , Gjatë këtij viti ka pasur organizime të ndryshme të komunitetit për punë vullnetare për rregullim të parqeve të ndryshme , zhdukjen e deponive ilegale dhe shëndrrimin e hapsirave të ndotura në ambiente të pastërtë . Krahas kompanisë që është e kontraktuar për mbledhjen e mbeturinave , në fshatin Kaçanik i Vjetër dhe Begracë kemi edhe operatorin privat që mirret me këtë punë .

Të gjitha aktivitetet vullnetare që janë bërë nga komuniteti ne si komunë jemi munduar të i mbështesim me kapacitetet tona që kemi në dispozicion . Krahas punëve të përditshme egzistojnë edhe disa data ku organizohen aktivitete për ambient dhe mjedis . Para disa ditëve kan ndodhë ndryshime në menaxhmentin e kompanisë së pastërtisë dhe po shpresojmë që kompania do të ndryshoj për të mirë në kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve . Ka ankesa se automjetet që bartin mbeturina po e rrjedhin rrugëve lëngun e mbeturinave por që edhe kët defekt do ta sanojmë .

**Sh.Abazi:** stadioni i qytetit nuk ka përkujdesje nga askush sa i përket mbeturinave . Nuk ka as kontanjer e as shporta për mbeturina dhe as intersim të kompanisë për të ndryshuar kët ambient .

**R. Osmani :** do ta marrim për bazë kët shqetësim dhe kontanjerët do të vendosen në kët hapsirë .

**K.Sallahu:** Problematikën e mbeturinave e kemi shprehur në çdo takim. Si komunitet kemi ngritur shqetësimë në Komunë, por edhe në Kompaninë "Pastërtia". Po flas për fshatin Biçec, ku komuniteti i këtij fshati i cili është përfshirë 100 për qind në sisitemin e mbeturinave. Ka qenë shumë i përgjegjeshëm në pagesën e faturave për shërbimet ndaj kompanisë, por kompania nuk ka qenë në nivelin e duhur të detyrës. Shpresojmë që me ndryshimet që janë bërë në menaxhment, do të ketë edhe përmirësimë në shërbime. Përndryshe, duhet të bëhet një zgjidhje. Mendoj se duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë investimeve në mjedis.

### **4.Formimi i grupit punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2021**

Në kët pikë të rendit të ditës , Kryetari propozoi që gruji që ka punuar në përpilimin e Planit të Punës për vitin 2020 të kryejë kët punë edhe për vitin 2021 dhe me kët rast i përgëzoi kët grup për punën e bërë . Grupi ishte i përbërë nga Zahir Doda , Lirije Luta dhe Kjani Sallahu .

Me kët propozim të Kryetarit u pajtuan të gjithë dhe grupei punues propozim planin do ta përgatis për mbledhjen e fundit të këtij viti për miratim në KKSB .

### 5. Të ndryshme

**J.Selimi :** u fol më herët në lidhje me formimin e TASK-FORC-ës në komunë dhe më intereson të dijë se pse nuk është përfshirë Këshilli i Prindërve . Një shqetësim tjetër kisha me ngritë për zhvendosjen e nxënësve nga shkolla e vjetër në shkollën e re në Kaçanik të Vjetër . Ky shqetësim vie nga vet komuniteti i këtij fshati dhe ata janë të intersuar që të mbajnë një takim me institucionet arsimore komunale dhe të gjenjë një zgjidhje .

**Kryetari:** Në lidhje me TASK-FORC-ën e formuar në komunë për menagjim të situatës nëpër shkolla , ne kemi marrë rekondit të cilët kanë përcaktuar akterët të cilët mundë të jenë në kët TASK-FORC-ë .

**Z.Doda:** Lidhur me zhvendosjen e nxënësve ne vetëm kemi përkrahur propozimin që na ka ardhë nga kjo shkollë , por që jemi të gatshëm që të bisedojmë edhe me komunitetin dhe të ofrojmë zgjidhje më të mirë .

**L.Luta :** Shfrytëzoj rastin të falënderojmë Kryetarin për përkrahjen që na ka dhënë në kampajën që ka organizuar Komiteti për Komunitete në lidhje me vtdijësimin e qytetarëve për masat ndaj virusit COVID-19 .

### REKOMANDIMET:

- 1.Të mirren masa ndaj zyrtarëve të pyjeve që po bashkëpunojnë me dëmtuesit
- 2.Angazhim maksimal në ruajtjen e shëndetit në përgjithsi
- 3.Angazhim i përbashkët në parandalimin e dëmtimit të pyjeve
- 4.Të mirren masa ndaj personave që prishin imazhin e mësimdhënësit me sjellje devijante
- 5.Të investohet më shumë në ruajtjen e ambientit dhe mjedisit .

Pas këtyre diskutimeve Kryetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës .

Kryesuesi: Kryetari i Komunës



z. Besim Ilazi

Procesmbajtës:

Fatmir Qaka